



KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 36, datë 05.04.2017

PËR

“MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, INSPEKTORIATIT TË MBROJTJES SË TERRITORIT, AGJENCISË SË MBROJTJES SË KONSUMATORËVE, AGJENCISË SË PARQEVE DHE REKREACIONIT, DHE TIRANA PARKING”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1/1.1 shkronja “b”, nenit 54 shkronja “ç” dhe nenit 55 pika 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 2, shkronja “c” dhe nenit 5 të Ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165, datë 02.03.2016 për “Grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” (i ndryshuar); dhe vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.84, datë 29.12.2016, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017” (i ndryshuar), me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I:

1. Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, sipas lidhjes nr.1 bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, sipas lidhjes nr.11 bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, sipas lidhjes nr.13 bashkëngjitur këtij vendimi.
4. Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, sipas lidhjes nr.15 bashkëngjitur këtij vendimi.
5. Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e ‘Tirana Parking’, sipas lidhjes nr.16 bashkëngjitur këtij vendimi.

6. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Mars 2017 dhe do të përballohen nga buxheti i miratuar i këtyre institucioneve për vitin 2017.
7. Shfuqizimin e lidhjes së pagave nr.13 në pikën 3 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 10, datë 12.10.2011 për “Krijimin e Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë së Tiranës”.
8. Shfuqizimin e lidhjes së pagave nr.1 dhe 15 në pikën 2.2 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 58, datë 30.12.2015 për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”.
9. Shfuqizimin e lidhjes së pagave nr.16 në pikën 5 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 48, datë 11.11.2015 për “Krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimin e shërbimit të parkimit public me pagesë”.
10. Shfuqizimin e lidhjen e pagave nr.11 në pikën 5 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.68, datë 07.10.2016 për “Disa ndryshime në nivelin e pagave dhe numrin e punonjësve të institucioneve të varësisë”.
11. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Financës, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorëve, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit dhe Tirana Parking.
12. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

Lidhja Nr.1

Niveli i pagave për punonjësit e “Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore”

Nr.	Pozicioni	Kategoria/ Klasa	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion
I	<i>Punonjes te sistemit me page grupi + shtese pozicioni</i>		1	2	3
1	Drejtori i Përgjithshëm	II-a	1	2%	115 000
2	Drejtor Drejtorie	II-b	1	2%	90 000
3	Përgjegjës sektori	III-a	1	2%	75 000
4	Specialist I	III-b	1/2	2%	55 000
5	Specialist II	IV-a	1/2/3	2%	44 000
6	Specialist me arsim të mesëm	IV-c	4	2%	34 000
II	<i>Punonjes te sistemit me klasa</i>	Klasa		Shtesa për vjetërsi	Paga bazë
7	Shofer	IV		1%	36 000
8	Punonjës mbështetës	III		1%	34 000
9	Pastrues	I		1%	30 000

1.Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr.1 per kategorinë I**, të jepet **në masën 2%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

2.Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr.1 për kategorinë II**, të jepet **në masën 1%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet mbi pagën bazë të klasës së I.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË E TË MESËM

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e arsimit të lartë:	
1	Master i Shkencave, Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë
4	Diplomë e arsimit të mesëm	8 000 lekë

Lidhja Nr.11

Niveli i pagave për punonjësit e “Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”

Nr	Pozicioni	Paga individuale			Paga mujore	
		Kategoria/ Klasa	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion	Shtesa për kushte pune
I	<i>Punonjes te sistemit me page grupi + shtese pozicioni</i>		1	2	3	4
1	Kryeinspektor	II-a	1	2%	115 000	
2	Drejtor	II-b	1	2%	90 000	
3	Përgjegjës sektori	III-a/1	1	2%	65 000	
4	Përgjegjës sektori te zonave	III-a/1	1	2%	65 000	5 000
5	Inspektor	III-b	1/2	2%	58 000	5 000
6	Specialist I	III-b	1/2	2%	58 000	
7	Specialist II	IV-a	1/2/3	2%	47 000	
8	Specialist me arsim të mesëm	IV-c	4	2%	38 000	5 000
II	<i>Punonjes te sistemit me klasa</i>	Klasa		Shtesa për vjetërsi	Paga bazë	
9	Punonjës mbështetës, shofer	IV		1%	36 000	
10	Pastrues	I		1%	30 000	

1.Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr.11 per kategorinë I**, të jepet në masën **2%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet **mbi pagën e grupit**.

2.Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr.11 per kategorinë II**, të jepet në masën **1%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet **mbi pagën bazë të klasës së I**.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË E TË MESËM

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e arsimit të lartë:	
1	Master i Shkencave, Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë
4	Diplomë e arsimit të mesëm	8 000 lekë

Lidhja nr.13**Niveli i pagave për punonjësit e “Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit”**

Nr.	Pozicioni	Kategoria/ Klasa	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion
I	<i>Punonjes te sistemit me page grupi + shtese pozicioni</i>		1	2	3
1	Drejtori i Përgjithshëm	II-a	1	2%	115 000
2	Drejtor Drejtorie	II-b	1	2%	90 000
3	Përgjegjës sektori	III-a	1	2%	75 000
4	Përgjegjës sektori	III-a/1	1	2%	64 000
5	Specialist I	III-b	1/2	2%	55 000
6	Specialist II	IV-a	1/2/3	2%	44 000
II	<i>Punonjes te sistemit me klasa</i>	Klasa		Shtesa për vjetërsi	Paga bazë
7	Sekretare	IV		1%	36 000
8	Punonjës sherbimi	III		1%	32 000
9	Pastrues	I		1%	30 000

1.Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr.13 per kategorinë I**, të jepet në masën **2%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet **mbi pagën e grupit**.

2.Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr.13 per kategorinë II**, të jepet në masën **1%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet **mbi pagën bazë të klasës së I**.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TËARSIMIT TË LARTË

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e arsimit të lartë:	
1	Master i Shkencave, Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë

Lidhja Nr.15

Niveli i pagave për punonjësit e “Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit”

Nr	Pozicioni	Kategoria/ Klasa	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për veshtiresi	Shtesa për pozicion
I	<i>Punonjes te sistemit me page grupi + shtese pozicioni</i>		1	2	3	
1	Drejtori i Përgjithshëm	II-a	1	2%		115 000
2	Zv/Drejtor i Përgjithshëm/ Drejtor Drejtorie, Drejtor Njësie	II-b	1	2%		90 000
3	Përgjegjës sektori, Kryeinspektor	III-a	1	2%		75 000
4	Specialist I, Inspektor I	III-b	1/2	2%		55 000
5	Specialist II, Inspektor II	IV-a	1/2/3	2%		44 000
II	<i>Punonjes te sistemit me klasa</i>	Klasa		Shtesa për vjetërsi	Shtesa për veshtiresi ne %	Paga bazë
1	Manovrator	IX		1%	10%	36 000
2	Shofer automjeti mbi 2,5 t	VIII		1%	10%	35 400
3	Magaznier	VII		1%	5%	35 000
4	Teknikë të mesëm të specialiteteve të ndryshme (mekanik, hidraulik etj.)	VI		1%		34 500
5	Krasitës, kositës dhe punëtor shërbimi kafshësh	VI		1%	5%	34 500
6	Punëtor sere	V		1%		34 100
7	Shofer autoveture, shofer automjeti deri 2.5 t,	V		1%		34 100
8	Punëtorë mirëmbajtës të profesioneve të ndryshme (punëtor parqe)	IV		1%		33 400
9	Drejtues motokarro, punonjës ngarkim-shkarkimi	III		1%		32 500
10	Biletashitës	II		1%		31 600
11	Pastruese	I		1%		30 000

1.Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr.15 per kategorinë I**, të jepet në masën **2%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet mbi **pagën e grupit**.

2.Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr.15 per kategorinë II**, të jepet në masën **1%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet mbi **pagën bazë**.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e arsimit të lartë:	
1	Master i Shkencave, Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë

Niveli i pagave për punonjësit e “Tirana Parking”

Nr	Pozicioni	Kategoria/ Klasa	Grupi	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për pozicion
I	<i>Punonjes te sistemit me page grupi + shtese pozicioni</i>		1	2	3
1	Drejtor i Përgjithshëm	II-a	1	2%	115 000
2	Drejtor	II-b	1	2%	90 000
3	Përgjegjës sektori, Kryeinspektor	III-a	1	2%	75 000
4	Inspektor	III-b	1/2	2%	55 000
5	Specialist I	III-b	1/2	2%	55 000
6	Specialist II	IV-a	1/2/3	2%	44 000
II	<i>Punonjes te sistemit me klasa</i>	Klasa		Shtesa për vjetërsi	Paga bazë
7	Punonjës shërbimi	V		1%	36 000
8	Shofer	IV		1%	35 000
9	Pastrues, Roje	I		1%	30 000

1.Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr.16 per kategorinë I**. të jepet në masën **2%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet mbi **pagën e grupit**.

2.Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen nr.16 per kategorinë II**. të jepet në masën **1%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet mbi **pagën baze të klasës së I**.

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT TË LARTË

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e arsimit të lartë:	
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë